



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 27/11/2019, (dy mije e nentëmbëdhjete), përpara meje Noterit **Jorida Dabulla**, me zyre te ndodhur ne rrugën **Sami Frasheri**, perballe Drejtorise se Policise, u paraqiten palët kontraktuese si me poshtë :

PALA SHITESE: **Z. Ilir Vardhami**, shtetas shqiptar, i biri i Jani, lindur më 07/03/1969 në Gjirokaster, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit (kartë identiteti) me nr. 027971405 dhe nr. Personal G90307185K, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i vetem i **Shoqërisë “PROFTRANS” Sh.p.k.** me seli Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 2, Shkalla 2, Kati 2, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 25/01/2018 me NIPT L81325027S, e përfaqësuar ligjërishit nga Administratori dhe ortaku i vetem, ne vijim i quajtur **Shitës**;

PALA BLERESE:

Shoqeria “ADR TRANS” shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Farke, Mjull Bathore, Rruga Akacia, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 04/01/2013 me NIPT L31304034G e perfaqesuae ligjerisht nga Ortaku i vetem, Shoqeria “NCI” shpk NIPT **L41709011G**, e perfaqesuar nga Administratori **Z. Ergys Halili**, Shoqeri e cila zoteron 100% te kapitalit te shoqerise “ADR TRANS”, (ne vijim blerësi);

Parashtruar qe:

- Shoqëria **“PROFTRANS” Sh.p.k.** me seli Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 2, Shkalla 2, Kati 2, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 25/01/2018 me NIPT L81325027S, ka ortak te vetem Z. Ilir Vardhami, qe zotëron 100 % te kapitalit te shoqërisë **“PROFTRANS” sh.p.k.**, sipas ekstraktit te QKR-se dates 25/11/2019 i bashkëlidhur;

- Me vendim te Asamblesë se Ortakeve te Shoqerise **“PROFTRANS” sh.p.k.** me date 26/11/2019, është vendosur shitja e kuotave ne masen 51% te kapitalit te shoqerise tek blerësi **Shoqeria “ADR TRANS”**.

- Me vendim te Asamblesë se Ortakeve te Shoqerise **“ADR TRANS” sh.p.k.** me date 26/11/2019, është vendosur blerja e kuotave ne masen 51% te kapitalit te shoqerise shitesë **“PROFTRANS”**.

- Shoqëria ka nevojë për investime dhe financime nëpërmjet pjesëmarrjes se ortakeve te rinj ne përbërjen e saj;

Sa me sipër u parashtrua është pjese integruese e kësaj kontrate.

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

NENI 1

OBJEKTI KONTRATËS

Ortaku i "PROFTRANS" sh.p.k., **Z. Ilir Vardhami** vendos ti shesë 51% te kuotave qe zotëron ne Shoqërine "PROFTRANS" sh.p.k. Blerësit si ne vijim:
Shoqëria "ADR TRANS" sh.p.k. e perfaqesuar nga Ortaku i vetem **Z. Ergys Halili**, i shitet 51% te kapitalit te shoqërisë dhe me numer kuote 1, i cili pranon ti blejë;

NENI 2

ÇMIMI DHE PAGESA

2.1 Palët deklarojnë qe çmimi është paguar jashtë kësaj zyre noterie dhe nuk kane me asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

NENI 3

PRONËSIA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrene te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palës blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet pales blerëse ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje. Nga ky moment blerësit i transferohet pronësia e kuotave dhe si pasoje shoqëria "PROFTRANS" sh.p.k. do te ketë si ortake personat si vijojnë:

- Shoqëria "ADR TRANS" sh.p.k. do te zoteroje 51% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote.
- **Z. Ilir Vardhami**, do te zoteroje 49% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote.

Kjo kontrate u hartua ne 3 kopje te njejta ne baze te vendimimeve te Ortakeve te shoqërive/ortakeve respektive, pjese e kesaj marreveshje, akteve te themelimit te shoqërive dhe ne baze te ligjit n. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe konform kontrates se koncesionit se dates 11.09.2009.

PALET KONTRAKTUËSE

PALA SHITËSE

Z. ILIR VARDHAMI




PALA BLERËSE

Shoqëria "ADR TRANS" shpk

Ortaku i vetem NCI Shpk

Z. ERGYS HALILI



NOTERI
JORIDA DABULLA

